VENDIM
Nr. 266, datë 28.12.2020

PËR MIRATIMIN E KODIT TË MATJES SË GAZIT NATYROR NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 4, pika 33, 44; nenit 104, pika 1 dhe nenit 116, pika 4, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror me nr. 142/9 prot., datë 24.12.2020, "Për miratimin e kodit të matjes së gazit natyror" në Shqipëri,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 165 datë 22.10.2020, Bordi i ERE-s ka vendosur, "Fillimin e procedurës për shqyrtimin e draftit të 'Kodit të matjes së gazit natyror' në Shqipëri".

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u bënë publikimet në faqen e *web*-it të ERE-s, njoftimi në median e shkruar me shkresën e ERE-s nr. 62/32 prot., datë 2.11.2020, si dhe njoftimi për botimin në Fletoren Zyrtare me shkresën e ERE-s nr. 68/37 prot., datë 3.11.2020, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 11.11.2020.

- Për të marrë opinionet e palëve të interesuara referuar vendimit të Bordi i ERE-s me nr. 165, datë 22.10.2020, ERE, me anë të shkresës nr.1160 prot., datë 2.11.2020, iu drejtua: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetit të Konkurrencës (AK), Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, Anio Oil & Gas" sh.p.k., "Phoenix Petroleum" sh.a., "Albgaz" sh.a., "C.G.C" sh.p.k., "Balkgaz" sh.p.k., "TAP AGAlbania" sh.p.k, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë Elektrike, me qëllim që palët e interesuara të shprehnin, brenda 30 ditëve, opinionet dhe komentet e tyre.

- Në përfundim të afatit, me qëllim dhënien apo marrjen e mendimeve ose propozimeve, në lidhje me draftin e "Kodit të matjes të gazit natyror", rezulton se me shkresën nr. 1520/1 prot., datë 1.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 1160/1 prot., datë 9.12.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Meterologjisë shprehet parimisht dakord për fillimin e kësaj procedure.

-"Albgaz" sh.a., me shkresën nr. 191/1 prot., datë 16.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 1160/1 prot., datë 16.12.2020, parashtron komentet dhe opinionet e trajtuara në relacionin përkatës, të cilat u morën parasysh edhe pse kishte kaluar afati i dorëzimit të tyre, në kuadër të gjendjes në kushtet pandemisë së COVID-19.

- ERE, nga komentet e propozuara nga "Albgaz" sh.a., ka pranuar dhe reflektuar në "Kodin e matjes se gazit natyror" pikat siç vijojnë:

- pikat: 2.1.2; 3.3.7; 5.1.1; Komente të përgjithshme; pikat: 3;4;6; Komente të veçanta; pikat: 1.4.1;2.1.1;2.1.2;2.4.1;2.7.2;2.7.3;2.7.5;3.2.3;3.3(a); 3.4.3;4.8;5.1.1; pikat: 30; 32; 33; 34; 35; 37 në relacion.

- ERE, nga komentet e propozuara nga "Albgaz" sh.a. nuk ka pranuar pikat siç vijojnë:

- pika 2.2.1; pika 5.1.2(h); komente të përgjithshme 2; 5, komente të veçanta, pikat: 1.5; 2.3.1;2.5.3;2.6.2;2.7.4;3.1.2;3.2.2;3.3.1;3.3.3;3.4.6;3.5.1;3.6.1;3.6.2;4.2.1;4.3.1;4.3.2;4.3.4;4.3.6(b);4.6.1;4.9.1;5.1.4; pikat 36 dhe 38 në relacion.

- Në datë 27.11.2020, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, me anë të një *email*-i zyrtar parashtron komente dhe pyetje të cilat janë reflektuar të gjitha në "Kodin e matjes të gazit natyror" që janë pikat si vijon:

- Nuk rezulton të ketë asnjë koment, vërejtje apo sugjerim nga palë e tjera të interesit, në lidhje me përmbajtjen e draftit të "Kodit të matjes të gazit natyror" me të cilin Bordi i ERE-s ka filluar procedurën.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e "Kodit të matjes së gazit natyror" në Shqipëri.

2. Hyrja në fuqi e "Kodit të matjes së gazit natyror" do të jetë 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KODI I MATJES SË GAZIT

Tabela e përmbajtjes

1. HYRJE
1.1 Titulli
1.2 Autoriteti
1.3 Përkufizimet dhe interpretimi
1.4 Zbatimi
1.5 Marrja e një kopje të këtij "Kodi të Matjes së Gazit"
2. DISPOZITA E INSTALIMIT TË MATJES
2.1 Detyrimi për instalimin e matësve
2.2 Moskthimi
2.3 Sigurimi i instalimeve të matjes
2.4 Instalimi
2.5 Baza e të dhënave të instalimit
2.6 Standardet minimale të saktësisë
2.7 Siguria
3. TESTIMI I INSTALIMIT TË MATJES
3.1 Akreditimi dhe certifikimi
3.2 Testimi i pranimit dhe testimi i tipit të instalimeve të matjes
3.3 Detyrimi për të testuar instalimet e matjes
3.4 Klasat e matësve
3.5 Sigurimi i rezultateve të testit
3.6 Matës që nuk përputhen
3.7 Korrigjimi
3.8 Vulosja dhe etiketimi
4. LEXIMI I MATËSIT DHE TË DHËNAVE
4.1 Ekuivalentimi i sasisë së gazit në energji
4.2 Leximi i matësit për transferimin e klientit
4.3 Mbledhja e të dhënave të matjes
4.4 Vlerësimi dhe zëvendësimi i të dhënave të matjes
4.5 Vlerësimi i të dhënave të matjes
4.6 Ruajtja e të dhënave të matjes
4.7 Hyrja në të dhënat e matësit
4.8 Konfidencialiteti
4.9 Pronësia e të dhënave të matjes
5. PLANI I MENAXHIMIT TË MATJES SË GAZIT
6. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI
Përkufizimet
Interpretimi
Shtojca 1 – Vlerësimi, zëvendësimi dhe parashikimi – Instalimi i matësit me interval
1. Kërkesa për të vërtetuar leximet e matësve
2. Kërkesa për të prodhuar të dhënat matëse të zëvendësuara

3. Kërkesa për të prodhuar të dhëna të parashikuara të matjes
4. Detyrimet e transmetuesit ose shpërndarësit
5. Tipat e zëvendësimit dhe parashikimit
Shtojca 2 – Vlerësimi, zëvendësimi dhe parashikimi – Instalimi i matësit bazik
1. Kriteret për të vlerësuar leximet e matësve
2. Kriteret për të prodhuar të dhënat matëse të zëvendësueshme
3. Kriteret për të prodhuar të dhëna të vlerësuara të matjes
4. Detyrimet e shpërndarësit
5. Tipat e zëvendësimit dhe vlerësimit

1. HYRJE

1.1 Titulli

1.1.1 Ky Kod është "Kodi i matjes së gazit".

1.2 Autoriteti

1.2.1 "Kodi i matjes së gazit" është bërë në përputhje me ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe si pjesë e veçantë nga "Kodi i transmetimit të gazit" në Shqipëri.

1.3 Përkufizimet dhe interpretimi

1.3.1 Fjalët që shfaqen me shkronja të zeza si këto janë përcaktuar në pikën 6, të këtij "Kodi të matjes së gazit".

1.3.2 Kodi duhet të interpretohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në pikën 6, të këtij "Kodi të matjes së gazit".

1.4 Zbatimi

1.4.1 "Kodi i matjes së gazit" rregullon kërkesat teknike për matësit dhe instalimet e matjes në pikat e transmetimit dhe/ose shpërndarjes së klientit.

1.4.2 Personat e lidhur me këtë Kod janë tregtar me pakicë dhe/ose shumicë, si dhe OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar.

1.5 Marrja e një kopje të këtij "Kodi të matjes së gazit"

1.5.1 Një OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, kur i kërkohet nga një klient, t'i dërgojë atij klienti, brenda 10 ditëve të punës, një kopje të këtij "Kodi të matjes së gazit" (dhe çdo ndryshim të bërë kohë pas kohe që ndikon materialisht në të drejtat, privilegjet ose detyrimet e një konsumatori), pa tarifë për kërkesën për herë të parë nga ai klient.

2. DISPOZITA E INSTALIMIT TË MATJES

2.1 Detyrimi për instalimin e matësve

2.1.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë një instalim të matjes së intervalit në pikat e transmetimit ose shpërndarjes për të cilat niveli vjetor i konsumit të gazit është më i madh se kwh/vit, ose nm^3/vit në vit, dhe pritet të mbetet më i lartë se kwh/vit, ose nm^3/vit.

2.1.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar nuk duhet ta mbajë peng miratimin e tij për kërkesën e ardhur nga një tregtar me pakicë që kërkon të instalojë një sistem matje të ndryshëm nga ai që është i instaluar, ose të ndryshëm nga ai lloj matësi që do të instalonte OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar, me kusht që instalimi i matjes të plotësojë çdo kërkesë teknike të zbatueshme (përfshirë ato që kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar).

2.1.3 Kostoja shtesë e sigurimit dhe instalimit të një sistemi të ri matës, sipas pikës 2.1.2, do të paguhet nga pala që fillon ndryshimin, në masën e lejuar nga një tarifë.

2.2 Moskthimi

2.2.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që një sistem i matjes së intervalit të mos zëvendësohet nga një sistem bazë i matjes para fundit të jetës së tij ekonomike, përveç rastit kur transmetuesi dhe shpërndarësi do të kishte përcaktuar që konsumi i gazit në pikën e transmetimit dhe/ose shpërndarjes do të ulet nën kwh/vit, ose nm^3/vit në vit, për shkak të ndryshimeve të rëndësishme në përdorimin e pajisjeve.

2.2.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të raportojë në ERE, gjatë periudhës së aprovimit të investimeve, të gjitha rastet kur ai ka zëvendësuar një matës intervali me një matës bazik, në përputhje me përcaktimin e OST-së, OSSH-së dhe/ose Operatorit të Kombinuar, të bërë në pikën 2.2.1.

2.3 Sigurimi i instalimeve të matjes

2.3.1 Një sistem i matjes duhet të përmbajë një regjistër të dhënash që:

a) të jetë i dukshëm dhe i arritshëm për të lexuar të dhënat e matësit;

b) lejon që të dhënat e matësit të aksesohen dhe lexohen në kohë reale nga një kompjuter apo pajisje të llojeve apo specifikime të tjera, të pranueshme në mënyrë të arsyeshme për të gjithë personat që kanë të drejtë të kenë qasje në ato të dhëna të matjes.

2.4 Instalimi

2.4.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të instalojë matësit sa më afër që të jetë e mundur në pikën e livrimit.

2.4.2 Shpërndarësi OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të instalojë matës në një pozicion i cili lejon qasje të sigurt dhe të papenguar për çdo person, detyrimi i të cilit është të testojë, rregullojë, mirëmbajë, riparojë ose zëvendësojë instalimin e matjes, ose të mbledhë të dhëna matëse nga sistemi i matjes.

2.5 Baza e të dhënave të matjes

2.5.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të mbajë një bazë të të dhënave të sistemit të matjes, në lidhje me secilin instalim të matjes.

2.5.2 Baza e të dhënave të instalimit duhet të përmbajë të paktën informacionin vijues:

a) Numrin e Regjistrimit të Instalimit të Matjes (NRIM);

b) Vendndodhjen e secilit matës të instaluar, korrigjuesit dhe regjistruesit të të dhënave;

c) Markën, modelin dhe vitin e prodhimit për secilin matës, korrigjues dhe regjistrues të të dhënave;

d) Për secilin matës, korrigjues dhe regjistrues të dhënash që është instaluar, adresën e klientit dhe datën e instalimit;

e) Datën e planifikuar për testimin ose zëvendësimin e të gjitha pajisjeve të përdorura për të matur sasinë e gazit;

f) Të dhëna për performancën e secilës pajisje të përdorur për të matur sasinë e gazit (kur është e përshtatshme);

g) Regjistrat e kalibrimit të të gjitha pajisjeve të përdorura për të matur sasinë e gazit;

h) Regjistrat e testimit të të gjitha pajisjeve të përdorura për të matur sasinë e gazit;

i) Datën dhe detajet e të gjitha vulave dhe etiketave të aplikuara të matësit dhe të korrigjuesit;

j) Datën dhe detajet e mirëmbajtjes më të fundit të të gjitha pajisjeve të përdorura për të matur sasinë e gazit; dhe

k) Datën tjetër të planifikuar për mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve të përdorura për të matur sasinë e gazit.

2.5.3 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të ruajnë informacionin që përmbahet në bazën e të dhënave të instalimit:

a) në një format të arritshëm, për një periudhë minimale prej 16 muajsh nga data e përfshirjes së informacionit në bazën e të dhënave; dhe

b) në arkiv, për 7 vjet nga data e përfshirjes së informacionit në bazën e të dhënave, ose për dymbëdhjetë muaj pas jetës së instalimit të matësit përkatës, cilado që është më e gjatë.

2.5.4 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojnë, pas marrjes së kërkesës me shkrim, akses në informacionin e të dhënave në instalimin përkatës, të palës së prekur:

a) brenda dy ditëve të punës, kur informacioni është në një format të arritshëm siç kërkohet në pikën 2.5.3 (a); dhe

b) përndryshe brenda tridhjetë ditëve të punës, nga data e marrjes së kërkesës.

2.6 Standardet minimale të saktësisë

2.6.1 Standardet minimale të saktësisë për instalimet e matjes janë brenda një kufiri saktësie plus ose minus 2% të vëllimit neto të gazit të dorëzuar në atë pikë të dërgesës.

2.6.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që funksionimi i instalimit të matjes nuk tregon ndikim sistematik brenda kufijve të lejuar të saktësisë.

2.6.3 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që secili prej instalimeve të tij të matjes që përmbajnë rregullatorë presioni janë në gjendje të sigurojnë rrjedhje të mjaftueshme në presionin minimal të hyrjes së rregullatorit, dhe kur zbatohet një faktor i

fiksuar i presionit, është në gjendje të kontrollojë me besueshmëri presionin e daljes për të përmbushur kërkesat e instrumenteve të aplikueshme rregullatore.

2.6.4 Një person i lidhur me këtë kod nuk duhet të ndërhyjë ose të kalibrojë një matës, me qëllim të futjes së ndikuesve në matës.

2.7 Siguria

2.7.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të bëjnë përpjekjet më të mira për të siguruar që instalimi i matjes të mbrohet nga ndërhyrjet ose dëmtimet e paautorizuara.

2.7.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, që në lidhje me instalimet e reja të matjes, të sigurojë vula ose elemente të tjera sigurie që mundësojnë evidentimin e çfarëdo ndërhyrje në matës.

2.7.3 Pas njoftimit se një vulë është thyer, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të zëvendësojë një vulë të prishur më herët se:

a) rasti i parë që vizitohet instalimi i matjes për të lexuar; ose

b)

2.7.4 Shpenzimet e zëvendësimit të vulave të prishura përballohen si më poshtë:

a) nëse vula është thyer nga klienti, paguhet nga klienti; ose

b) nëse vula është thyer nga tregtari me pakicë dhe shumicë, paguhet nga tregtari me pakicë dhe/ose shumicë, ose

c) përndryshe nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar

2.7.5 Nëse si rezultat i ose në lidhje me prishjen ose dëmtimin e një vule, matësi përkatës mund të mos përmbushë më standardet përkatëse minimale të saktësisë, OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet:

a) testojë matësin në përputhje me klauzolën 3, brenda 15 ditëve të punës; ose

b) të zëvendësojë matësin në përputhje me pikën 3.6.

3. TESTIMI I INSTALIMIT TË MATJES

3.1 Akreditimi dhe certifikimi

3.1.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që matësit dhe korrigjuesit e blerë të kenë miratimin e modelit të Drejtorisë së Standardeve dhe të Matjes nga një laborator i akreditуar i njohur sipas Skemës Ndërkombëtare të Certifikimit, në përputhje me specifikimet ose udhëzimet e specifikuara nga Drejtoria e Standardeve dhe e Matjes.

3.1.2 Aty ku aprovimi i modelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Meterologjisë nuk kërkohet të sigurohet nga institucion tjetër, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të kryejë teste, ose duhet të bëjë që testet të kryhen, në lidhje me vendosjen, kalibrimin ose vërtetimin e saktësisë së matësve dhe korrigjuesve, nga persona, ose në një strukturë, të akreditуar nga DPM-j për të kryer teste të tilla.

3.1.3 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që pajisjet e kalibrimit, të përdorura në lidhje me kalibrimin e instalimeve të tyre matëse, janë të certifikuara nga një autoritet verifikues i autorizuar për të lëshuar certifikata sipas Rregullores DPM.

3.2 Testimi i pranimit dhe testimi i tipit të instalimeve të matjes

3.2.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të kryejë, ose të insistojë që të kryhet, teste të pranimit në matës, korrigjues dhe regjistruesit e të dhënave që janë përbërës të instalimeve të matjes në rrethanat e mëposhtme:

a) përpara se një matës i ri, korrigjuesi ose regjistruesi i të dhënave të vendoset në shërbim;

b) përpara se një matës, korrigjuesi ose regjistruesi i të dhënave që është hequr nga shërbimi të vendoset përsëri në shërbim; dhe

c) pasi të ketë përfunduar çdo riparim, mirëmbajtje ose rikalibrim i kryer në një matës, korrigjues ose regjistrues të dhënash.

3.2.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të miratojë një lloj të ri të sistemit të matjes vetëm nëse ai instalim i matjes i është testuar tipi.

3.2.3 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet t'i

një përdoruesi të sistemeve të tyre,

, kopjet e certifikatave përkatëse të testit të tipit që disponon, në lidhje me matësin sipas kërkesës.

3.2.4 Transmetuesi dhe/ose shpërndarësi duhet të mbajë regjistrime të testimit të tipit, sipas pikës 3.2.2, ndërsa matësit e atij lloji mbeten në shërbim, ose për një minimum prej 7 vjetësh, cilado që të jetë më e gjatë.

3.2.5 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që çdo matës që është modifikuar të vlerësohet për të përcaktuar nëse modeli i modifikuar vazhdon të përmbushë standardet minimale të përshkruara nga ky "Kod i matjes" dhe që matësit nuk ndryshojnë nga prova e llojit të tyre në masën që çdo ndryshim do të ndikonte në performancën e matësve.

3.2.6 Nëse ekzistojnë baza të arsyeshme për të konkluduar se modifikimet në një matës ndikojnë në aftësinë e tij matëse ose në testimin fillestar të llojit të tij, atëherë OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që instalimi i matjes të dorëzohet për test të tipit.

3.3 Detyrimi për të testuar instalimet e matjes

3.3.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar munden në çdo kohë, dhe duhet që brenda 15 ditëve të punës nga kërkesa e një tregtari me pakicë ose shumicë, të testojë një instalim matës për të konstatuar nëse instalimi i matjes është apo jo i dëmtuar.

3.3.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet t'i japë tregtarit me pakicë ose shumicë, që kërkon një test, njoftim të paktën 5 ditë pune (ose bien dakord reciprokisht për një kohë tjetër të përshtatshme) se kur propozohet të kryhet testi i kërkuar.

3.3.3 Nëse si rezultat i testit të kërkuar nga një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë, sipas pikës 3.3.1, instalimi i matjes rezulton të jetë:

a) me defekt, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të mbulojë shpenzimet e bëra gjatë kryerjes së provës; ose

b) pa defekt, transmetuesi ose shpërndarësi mund të kërkojë të rikuperojë koston e kryer gjatë kryerjes së provës.

3.3.4 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të publikojë tarifa për testimin e instalimeve të matjes. Tarifat duhet të jenë të drejta dhe të arsyeshme.

3.3.5 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar, sipas kërkesës, duhet t'i sigurojë tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë rezultatet e testit të kryer, sipas pikës 3.3.1, brenda 5 ditëve të punës.

3.3.6 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të mbajë regjistrime të testeve në përputhje me pikën 2.6.

3.4 Klasat e matësve

3.4.1 Periudha fillestare në shërbim e një klasë matësish është një periudhë e aprovuar nga DPM-ja që fillon në ditën kur një matës në atë klasë matësi u përdor për herë të parë në furnizimin me gaz të një klienti.

3.4.2 Nëse një transmetues dhe/ose shpërndarës synon të mbajë matësit në një klasë matësi pas përfundimit të periudhës fillestare të shërbimit për atë klasë matësi, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, përveç dispozitave të tjera të testimit të matësit në këtë kod, të krijojë dhe mirëmbajë një plan të testimit dhe marrjes së mostrave të aprovuar nga DPM-ja.

3.4.3 Plani i testimit dhe i marrjes së mostrave duhet të parashikojë që matësit të testohen si në 20% dhe 100% të kapacitetit nominal të matësve.

3.4.4 Kërkesat minimale të provës do të jenë në përputhje me standardet e DPM-së.

3.4.5 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatorit të Kombinuar i kërkohet që t'i sigurojë rezultatet e provave për të dy kapacitetet 20% dhe 100% për atë klasë matësi.

3.4.6 Nëse rezultatet e testit nuk përmbushin:

a) kufijtë maksimalë të lejueshëm të gabimit, për kapacitetin nominal të matësve në 20% dhe në 100%, siç përcaktohet në pikën 2.6, me një kufi pasigurie prej jo më shumë se 1%; dhe

b) kërkesa të tilla të tjera të planit të testimit dhe të marrjes së mostrave, të miratuara nga DPM-ja, atëherë OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të zëvendësojnë ose rikalibrojë të gjitha instalimet e matjes në atë klasë të matësve.

3.5 Sigurimi i rezultateve të testit

3.5.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, me kërkesë të DPM-së, t'i sigurojë ERE-s rezultatet e çdo prove të kryer në përputhje me këtë kod të matjes.

3.6 Matës që nuk përputhen

3.6.1 Nëse saktësia e një instalimi matësi nuk përputhet me kërkesat e këtij kodi të matjes, ose nëse një transmetues dhe/ose shpërndarës bëhet i vetëdijshëm për ndonjë çështje që mund të ndikojë në integritetin e të dhënave të matjes, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të mbulojë, me koston e OST-së, OSSH-së dhe/ose Operatorit të Kombinuar:

a) njoftojë palët e prekura sa më shpejtë të jetë e mundur;

b) rregullojë që saktësia e instalimit të matjes të rikthehet në mënyrë që ajo të përmbushë standardet minimale të saktësisë, ose që instalimi i matjes të zëvendësohet, brenda 10 ditëve të punës, kur konsumi në pikën e transmetimit dhe/ose të shpërndarjes është më pak se 10 tj për vit, dhe 5 ditë pune kur konsumi në pikën e transmetimit dhe të shpërndarjes është 10 tj në vit ose më shumë, ose një periudhë më e gjatë që mund të aprovohet nga ERE; dhe

c) deri në restaurimin ose zëvendësimin e instalimit të matjes, në përputhje me klauzolën 3.6.1 (b) përdorimi i leximeve zëvendësuese.

3.6.2 Kur ekziston një gabim i matjes dhe OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar propozon të zëvendësojë leximet e mëparshme të matësit, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të kufizojë zëvendësimin e leximeve të matësve në:

a) periudha kur gabimi i matjes ishte më i madh se 1.5 herë standardet minimale të saktësisë; dhe

b) periudhën kur ekziston gabimi i matjes, por jo më herët se 12 muaj para se të dihej gabimi i matjes nëse gabimi i matjes rezultoi në nën faturimin e klientit.

3.7 Korrigjimi

3.7.1 Gjatë ndërmarrjes së një leximi të matësit në një instalim matës, OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të rregullojë leximin e matësit për presionin, temperaturën ose mbipresionin e lejuar, ose një kombinim të këtyre faktorëve, përmes aplikimit të faktorëve të korrigjimit ose përdorimit të një korrigjuesi kur:

a) gabimi që rrjedh nga këto efekte tejkalon kërkesat e standardeve minimale; ose

b) gjendja e funksionimit ndryshon gjatë ditës duke ndikuar në presionin, temperaturën ose mbipresionin; ose

c) kur kërkohet ta bëjë këtë nga ERE.

3.7.2 Një OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të bëjë një rregullim për gabimin e matësit duke përdorur një korrigjues ose një faktor korrigjimi kur:

a) korrigjuesi dhe matësi për korrigjimin e specifikuar është identifikuar në mënyrë unike;

b) saktësia e matësit dhe/ose korrektorit është brenda standardeve minimale;

c) metoda e rregullimit nga korrigjuesi mund të ndryshojë; dhe

d) palët e prekura këshillohen për pajisjen e kompensimit dhe cilësimet e përdorura.

3.8 Vulosja dhe etiketimi

3.8.1 Një OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të vendosë një etiketë në çdo matës dhe korrigjues që i është nënshtruar një testi të pranimit dhe që rezulton se e ka kaluar testin. Etiketa duhet të përmbajë një shenjë dalluese dhe vitin e provës të bashkangjitur për të treguar se ajo e ka kaluar testin.

3.8.2 Nëse një matës ose korrigjues nuk është testuar ose është gjetur që nuk ka kaluar një test pranimi, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që nuk është etiketuar.

4. LEXIMI I MATËSIT DHE TË DHËNAVE

4.1 Ekuivalentimi i sasisë së gazit në energji

4.1.1 Gazi duhet të matet me sasi dhe të shndërrohet në njësi të energjisë për qëllime faturimi duke përdorur vlerën e ngrohjes së llogaritur nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar në përputhje me një metodologji të miratuar nga ERE.

4.2 Leximi i matësit për transferimin e klientit

4.2.1 Sipas kërkesës nga një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të bëjnë përpjekjet më të mira për të kryer një lexim aktual të matësit për të mundësuar transferimin e një klienti tek ai tregtar me pakicë dhe/ose shumicë brenda një kohe të arsyeshme të kërkesës.

4.2.2 Aty ku është instaluar një matës bazë, leximi përfundimtar i matësit para se një klient të transferohet në një shitës të ri pakice ose shumice, qoftë një lexim i planifikuar i matësit apo një lexim i veçantë i tij, duhet të dërgohet nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar të

shitësi i ri me pakicë dhe/ose shumicë, në përputhje përkatësisht me klauzolën 4.7.4 ose klauzolën 4.7.5.

4.3 Mbledhja e të dhënave të matjes

4.3.1 Në varësi të pikave 4.3.2 dhe 4.3.3, një klient mund të rregullojë me tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë mënyrën në të cilën të dhënat e ruajtura në një matës, të ofruara për klientin, do të mblidhen nga OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar.

4.3.2 Një klient mund të kërkojë që të dhënat e ruajtura në instalimet e matjes të mblidhen nga OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar:

a) duke inspektuar instalimin e matjes; ose

b) kur instalimi i matjes është i aftë të sigurojë të dhëna me mjete elektronike, me mjete elektronike; ose

c) kur instalimi i matjes është i aftë të sigurojë të dhëna me ndonjë mjet tjetër, me ndonjë mjet tjetër.

4.3.3 OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të faturojë një tregtar me pakicë dhe/ose me shumicë për mbledhjen e të dhënave të matjes, sipas kësaj klauzole 4.3.2, në masën që kostot e tij të mbledhjes janë më të larta se sa do të ishin përndryshe.

4.3.4 Kur të dhënat e matësit të mbajtura në instalimin e matjes janë të mbrojtura nga qasja e drejtpërdrejtë ose e largët e fjalëkalimeve të përshtatshme dhe kontrollet e sigurisë, fjalëkalimet dhe kontrollet e tilla të sigurisë duhet të përdoren.

4.3.5 Fjalëkalimet duhet të trajtohen si informacione konfidenciale në përputhje me pikën 4.8.

4.3.6 Nëse ka ndonjë mospërputhje, midis:

a) të dhënave të ruajtura në një instalim matës; dhe

b) të dhënave të matësit në lidhje me atë instalim të matjes, të dhënat e ruajtura në instalimin e matjes duhet të jenë prova e parë e sasisë së gazit ose energjisë, nëse është e zbatueshme, furnizuar te klienti përkatës.

4.4 Vlerësimi dhe zëvendësimi i të dhënave të matjes

4.4.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që të dhënat e matësit, të mbledhura nga një instalim i matjes së intervalit, sipas pikës 4.3:

a) është vërtetuar në përputhje me programin 1, klauzola 1, të këtij "Kodi të matjes"; dhe

b) kur është e nevojshme, zëvendësohet në përputhje me programin 1, pikat 2 dhe 4, të këtij kodi të industrisë.

4.4.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që të dhënat e matësit të mbledhura nga një instalim bazë i matjes, sipas pikës 4.3:

a) është vërtetuar në përputhje me programin 2, klauzola 1, të këtij "Kodi të matjes"; dhe

b) kur është e nevojshme, zëvendësohet në përputhje me programin 2, klauzola 2 dhe 4, të këtij "Kodi të matjes".

4.4.3 Kur testet, sipas pikës: 4.4.1 (a) ose 4.4.2 (a), tregojnë se ka pasur një dështim të instalimit të matjes ose se ekziston një gabim i matjes, të dhënat e matësit duhet të zëvendësohen në përputhje me pikën 4.4. 1(b) ose 4.4.2 (b) dhe OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet t'i sigurojë tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë të dhënat e matura, të zëvendësuara në mënyrë që tregtari me pakicë ose shumicë të mund të përmbushë detyrimet e tij të faturimit.

4.4.4 Nëse bëhet një zëvendësim i të dhënave të matjes, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të informojë tregtarin në përputhje me rrethanat për t'u siguruar që një faturë e lëshuar për klientin përkatës e informon atë klient se është bërë një zëvendësim.

4.4.5 Kur të dhënat e matësit në lidhje me një klient janë zëvendësuar dhe kërkohet të transferohen tek ERE, të dhënat e zëvendësuara duhet t'i sigurohen ERE-s nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar

4.4.6 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të mbajë një regjistër të veçantë të zëvendësimit të bërë në pikat: 4.4.1 dhe 4.4.2, për 7 vjet, dhe të sigurojë hyrjen në regjistër në kohë të arsyeshme për tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë të klientit përkatës.

4.5 Vlerësimi i të dhënave të matjes

4.5.1 Në varësi të pikave 4.3.2 dhe 4.3.3, një klient mund të rregullojë me tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë mënyrën në të cilën të dhënat e ruajtura në një instalim matës, të ofruara për klientin, do të mblidhen nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar.

4.6 Ruajtja e të dhënave të matjes

4.6.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të ruajë të dhënat e matësit, në lidhje me instalimet e ndara të matjes, në formën në të cilën janë mbledhur, sipas pikës 4.3:

a) në një format të arritshëm për një periudhë minimale prej 16-muajsh nga data e leximit të matësit; dhe

b) në arkiv, për 7 vjet nga data e leximit të matësit.

4.7 Hyrja në të dhënat e matësit

4.7.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet t'i japin klientit të një tregtari me pakicë dhe/ose shumicë aksesin në të dhënat e ruajtura në një matës të përdorur për të matur dhe regjistruar sasinë e gazit të furnizuar në pikën e tij të transmetimit ose të shpërndarjes, ose duke inspektuar instalimin e matjes ose, kur është e mundur, nga qasja elektronike në sistemin e matjes.

4.7.2 Kur të dhënat janë në dispozicion me mjete elektronike, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, me kërkesë me shkrim nga tregtari me pakicë dhe/ose shumicë i klientit, të sigurojë lehtësira për t'i mundësuar klientit të ketë qasje në të dhënat e ruajtura në një instalim matës, ku ato janë në dispozicion me mjete elektronike.

4.7.3 Kur OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar ka siguruar lehtësira për t'i mundësuar klientit të tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë të ketë qasje në të dhënat e ruajtura në një instalim matës me mjete elektronike të largëta, nëse qasja elektronike në distancë në instalimin e matjes është e padisponueshme për një periudhë prej 5 ditësh pune radhazi për shkak të veprimeve brenda kontrollit të OST-së, OSSH-së dhe/ose Operatorit të Kombinuar, duhet, nëse kërkohet nga klienti i tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë, të marrë të dhëna në nivel lokal nga instalimi i matjes dhe t'ia sigurojë ato të dhëna klientit të tregtarit me koston e OST-së, OSSH-së dhe/ose Operatorit të Kombinuar.

4.7.4 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që ofrohet qasje për tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë në të dhënat e matësit (qofshin ato aktuale, të zëvendësuara sipas pikës 4.4 ose të vlerësuara sipas pikës 4.5), në frekuencën e rënë dakord, nga ora 17.00 në ditën e parë të punës pas mbledhjes së të dhënave të matjes.

4.7.5 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që tregtari me pakicë dhe/ose shumicë t'i sigurohet aksesi në të dhënat e matësit nga leximet speciale të matësve dhe leximet përfundimtare të matësve, deri në orën 17.00 ose ditën e parë të punës pas mbledhjes së të dhënave të matjes.

4.7.6 Kur ofrohet akses për tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë në të dhënat e matësit sipas pikave 4.7.4 dhe 4.7.5, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që të jepen të dhëna shtesë që kërkohen nga tregtari me pakicë dhe/ose shumicë për të përmbushur detyrimet e tij sipas ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

4.8 Konfidencialiteti

4.8.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar dhe tregtari me pakicë dhe/ose shumicë duhet të mbajnë konfidenciale të dhënat e matësit dhe të bëjnë përpjekjet më të mira për të mbrojtur dhe ruajtur natyrën konfidenciale të të dhënave të matjes dhe duhet të jenë në përputhje me çdo instrument rregullator të zbatueshëm.

4.8.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar dhe tregtari me pakicë dhe/ose shumicë:

a) nuk duhet të zbulojnë të dhëna për matjen e një klienti te ndonjë person përveç rastit kur lejohet nga ky "Kod i matjes", ligji nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, Rregullorja e gazit, ose rregullat e tregut me shumicë dhe pakicë;

b) nuk duhet të përdorin ose riprodhojnë të dhëna matëse vetëm për një klient për qëllimin për të cilin janë mbledhur nën këtë kod të matjes ose një qëllim tjetër të parashikuar nga kodi i transmetimit dhe i shpërndarjes së gazit, ose procedurat e tregut me pakicë dhe shumicë;

c) nuk duhet të lejojnë persona të paautorizuar të kenë akses në të dhënat e matësit për një klient;

d) nuk duhet të zbulojnë të dhëna për matjen e një klienti te çdo person pa pëlqimin e qartë të klientit; dhe

e) duhet të sigurojnë që të dhënat e matësit dhe informacioni tjetër i marrë nga një klient të trajtohet në përputhje me pëlqimin e qartë të informuar të klientit dhe në përputhje me çdo akt rregullator të zbatueshëm.

4.8.3 Kjo klauzolë 4.8 nuk parandalon:

a) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes nëse të dhënat e matësit janë në atë kohë në dispozicion në përgjithësi dhe publikisht ndryshe nga sa rezultati i shkeljes së besimit nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar ose një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë ose zbulimi i tij;

b) zbulimi i të dhënave të matjes nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar ose një shitës me pakicë ose shumicë ose zbulimi i tij për:

i. punonjësit e saj ose punonjësit e organeve të tij përkatëse të shoqërisë, subjekt i ndonjë akti rregullues të zbatueshëm;

ii. ose këshilltari i tij ligjor ose tjetër profesional, auditor ose këshilltar tjetër, që kërkon të dhënat e matësit për qëllimet e këtij kodi të matjes ose ndonjë kodi të transmetimit dhe të shpërndarjes për këtë qëllim ose shitësit me pakicë ose shumicë;

c) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes me pëlqimin e qartë të informuar të klientit përkatës;

d) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes në masën e kërkuar nga ligji ose nga kërkesa e ligjshme e:

i. çdo institucioni shtetëror ose organi qeveritar, autoriteti ose agjencie që ka juridiksion mbi OST-në, OSSH-në dhe/ose Operatorin e Kombinuar ose një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë ose organet e tij përkatëse të korporatës;

ii. çdo burse (pronar) që ka juridiksion mbi OST-në, OSSH-në dhe/ose Operatorin e Kombinuar ose një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë ose të organeve të ndërmarrjes përkatëse; ose

iii. ERE-s;

e) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes të kërkuara, në lidhje me procedurat ligjore, arbitrazhin, përcaktimin e ekspertit ose mekanizëm tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas këtij kodi industrie ose ndonjë kodi tjetër të industrisë, ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", Rregullores së gazit, ose rregullave të tregut me shumicë dhe pakicë;

f) përdorimin e zbulimit ose riprodhimi i të dhënave të matjes, i cili është i parëndësishëm në natyrë;

g) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes të kërkuara për të mbrojtur sigurinë e personelit ose pajisjeve; ose

h) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes nga ose për llogari të

i) të paraqitur nga OST, OSSH ose Operatori i

j) Kombinuar në masën që kërkohet në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me aranzhimet e financimit të OST-së, OSSH-së dhe/ose Operatorit të Kombinuar ose tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë, investimet në shpërndarës e transmetuesit dhe/ose shpërndarësit ose tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë.

4.8.4 Në rastin e zbulimit sipas pikave 4.8.3 (b) dhe 4.8.3 (h), OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar ose tregtari me pakicë dhe/ose shumicë që bën zbulimin duhet të informojë zbulimin përkatës të konfidencialitetit të të dhënave matëse dhe bëjë përpjekjet më të mira për të siguruar konfidencialitetin e të dhënave të matjes.

4.9 Pronësia e të dhënave të matjes

4.9.1 Pronari i matësit është pronari i të gjitha të dhënave të matjes të prodhuara ose regjistruara nga ai matës. Çdo person tjetër që ka të drejtë të përdorë ato të dhëna matëse, sipas këtij kodi të matjes, ka të drejtën e një licence joekskluzive për të përdorur ato të dhëna matëse për qëllimet e biznesit të tij, në varësi të dispozitave të aktit rregullator.

5. PLANI I MENAXHIMIT TË MATJES SË GAZIT

5.1.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, brenda gjashtë muajve pas lëshimit të licencës së tij të transmetimit ose shpërndarjes ose fillimit të këtij kodi të matjes, cilado qoftë e mëvonshme, të përgatisë dhe t'i paraqesë ERE-s, një plan të menaxhimit të matjes së gazit.

5.1.2 Plani i menaxhimit të matjes së gazit duhet të përmbledhë procedurat e OST-së, OSSH - së dhe/ose Operatorit të Kombinuar për:

a) instalimin dhe pronësinë e instalimeve të matjes;

b) standardet minimale për instalimet e matjes dhe mirëmbajtjen e kësaj saktësie, duke përfshirë planin e testimit dhe marrjes së mostrave të përmendura në pikën 3.4;

c) mbledhjen e të dhënave të matjes;

d) testimin në terren dhe mirëmbajtjen e instalimeve të matjes;

e) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të matjes;

f) detyrimet e të dhënave të matjes;

g) menaxhimin dhe shkëmbimin e informacionit matës; dhe

h) matjen dhe llogaritjen e vlerës së ngrohjes, me qëllim të faturimit.

5.1.3 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të rishikojë çdo vit dhe, nëse është e nevojshme, të azhurnojë planin për të siguruar funksionimin e tij efikas dhe të paraqesë planin e përditësuar në ERE për aprovim.

5.1.4 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të jetë në përputhje me planin e përgatitur në përputhje me pikën 5.1.1 dhe siç azhurnohet herë pas here në përputhje me pikën 5.1.3.

5.1.5 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar nuk duhet të ndryshojë planin pa miratimin e ERE-s.

6. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

Përkufizimet

Në këtë kod të matjes:

"Testi i pranimit" nënkupton testimin dhe vendosjen e një matësi, korrektori ose një instalim matësi nga një prodhues ose instalues për të vendosur kalibrimin fillestar të matësit, korrektorit ose instalimit matës;

"Marrëveshje e hyrjes" do të thotë marrëveshja për aksesin e palës së tretë në një tubacion transmetimi ose shpërndarjeje të paraqitur nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar në përputhje me ligjin e gazit dhe rregulloret e gazit dhe i cili është aprovuar nga rregullatori përkatës;

"Akt" nënkupton aktet e nxjerra për gazin;

"Albgaz" do të thotë operatori i sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes;

"ERE" do të thotë Enti Rregullator i Energjisë;

"Leximi aktual i matësit" nënkupton mbledhjen fizike të të dhënave të matjes përmes një leximi të planifikuar të matësit ose një leximi të veçantë të matësit. Një lexim aktual i matësit mund të jetë e dhënë e matjes e cila është zëvendësuar në përputhje me pikën 4.4.1 (b), për një matës interval ose klauzolën 4.4.2 (b), për një matës bazë, por nuk përfshin të dhëna matëse të vlerësuara;

"Pala e prekur" do të thotë një palë që mund të preket nga pasaktësia e mundshme e një instalimi matës ose të dhënave të matjes nga ai instalim matës;

"Instrumente rregullatore të zbatueshme" do të thotë çdo akt ose instrument rregullator i bërë sipas një ligji, ose një instrumenti rregullator të lëshuar nga ERE, i cili zbatohet për një transmetues dhe/ose shpërndarës ose një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë;

"Matës bazë" do të thotë një matës pa regjistrues të dhënash;

"Instalim matës bazë" do të thotë një instalim matësi me matës bazë;

"Përpjekjet më të mira" do të thotë të veprosh me mirëbesim dhe të përdorësh të gjitha përpjekjet, aftësitë dhe burimet e arsyeshme;

"Korrigjues" do të thotë një pajisje e cila rregullon sasinë e pakorrigjuar të gazit nga kushtet aktuale në ato standarde për faturimin dhe qëllime të tjera;

"Klient" është një subjekt që blen me shumicë ose klienti fundor i gazit natyror, si dhe çdo subjekt tjetër i gazit natyror që blen gaz natyror;

"Klient me shumicë" është personi fizik ose juridik, i ndryshëm nga OST-ja ose OSSH-ja, i cili blen gaz natyror, me qëllim rishitjen brenda ose jashtë sistemit ku është i lidhur;

"Regjistrues i të dhënave" nënkupton një pajisje që mbledh dhe ruan të dhëna, në lidhje me sasinë, temperaturën dhe presionin e gazit dhe është në gjendje të:

a) transferojë të dhënat e regjistruara në një pajisje leximi portative; ose

b) qaset në mënyrë elektronike përmes një sistemi të mbledhjes së të dhënave;

"Defekt" do të thotë:

a) në lidhje me një instalim të ri të matjes, që nuk po plotëson standardet minimale; dhe

b) në lidhje me një instalim ekzistues të matësit, që nuk po plotëson standardet minimale të saktësisë që është projektuar për të përmbushur;

"Pikë e transmetimit dhe/ose shpërndarjes" do të thotë një pikë në sistemin e shpërndarjes në të cilën gazi tërhiqet nga sistemi i transmetimit ose shpërndarjes për transmetimin ose shpërndarjen te një klient dhe që normalisht ndodhet në:

a) hyrjen e instalimit të gazit të një klienti; ose

b) daljen e matësit;

"Pika e dorëzimit të kërkesës" ka kuptimin e dhënë në marrëveshjen standarde;

"Sistemi i transmetimit dhe/ose shpërndarjes" ka kuptimin që i është dhënë këtij termi në ligjin e gazit;

"Tubacioni i transmetimit dhe/ose shpërndarjes" ka kuptimin që i është dhënë këtij termi në ligjin e gazit;

"Transmetues" dhe/ose "Shpërndarës" do të thotë një person që mban një licencë sipas ligjit për të operuar një sistem transmetimit dhe/ose shpërndarjes;

"Leximi i vlerësuar" do të thotë një vlerësim në vend të leximit të matësit;

"Gaz" ka kuptimin që i është dhënë këtij termi në ligj;

"Udhëzim" do të thotë një udhëzues i botuar nga ERE;

"Baza e të dhënave të instalimit" do të thotë një bazë e të dhënave të kalibrimit të cilat një transmetues dhe/ose shpërndarës kërkohet të mbajë në lidhje me instalimet e tij të matjes në përputhje me këtë kod të matjes;

"Matës intervali" do të thotë matës me një regjistrues të dhënash;

"Instalim i matjes së intervalit" do të thotë një instalim i matjes me një matës të intervalit;

"Me shkrim" do të thotë komunikimi i bërë nga letra, faksimi ose media elektronike;

"Matës" do të thotë një instrument që mat sasinë e gazit që kalon përmes tij dhe përfshin pajisjet shoqëruese të bashkangjitura në instrument për të filtruar, kontrolluar ose rregulluar rrjedhën e gazit;

"Klasa e matësve" nënkupton një grup matësish në të cilët:

a) të gjithë matësit janë bërë në të njëjtat specifikime nga i njëjti prodhues;

b) nuk ka ndryshime të rëndësishme në përbërësit ose materialet midis matësve; dhe

c) të gjithë matësit janë vulosur me të njëjtën kod të dhënash;

"Të dhëna matëse" do të thotë masa e sasisë së rrjedhës së gazit të marrë nga një instalim matës;

"Instalim i matjes" do të thotë matësi dhe pajisjet me instalimet shoqëruese, të cilat mund të ndodhin që përfshijnë korrigjuesit, rregullatorët, filtrat, regjistruesit e të dhënave dhe telemetrinë në lidhje me një pikë shpërndarjeje;

"Standarde minimale" do të thotë, në lidhje me matësit e rinj, standardet minimale të referuara në DPM;

"Ligji i gazit" ka kuptimin që i është dhënë në ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror";

"Tremujor" do të thotë një periudhë prej trembëdhjetë javësh (13) nominalisht, por që nuk e kalon një periudhë prej katërmbëdhjetë (14) javë;

"Rregullat e tregut me shumicë dhe pakicë" do të thotë rregullat e administruara dhe të publikuara për tregun me pakicë ose shumicë;

"Tregtar me pakicë dhe/ose shumicë" do të thotë një person që mban një licencë sipas ligjit nr. 102/2015, ose një autorizim të tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë të dhënë nga ERE për shitjen dhe furnizimin e gazit;

"Lexim i planifikuar i matësit" do të thotë një lexim aktual i matësit në një cikël që barazohet me ciklin e faturimit të klientit, zakonisht mujor ose tremujor;

"Leximi special i matësit" do të thotë një lexim aktual i matësit që kryhet jashtë ciklit të zakonshëm të leximit për matësin;

"Adresa e furnizimit" do të thotë:

a) adresa për të cilën një klient blen gaz nga një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë, kur ka vetëm një pikë dorëzimi në atë adresë; ose

b) kur ka më shumë se një pikë dërgese në adresë, secila pikë e dorëzimit përmes së cilës klienti blen gaz nga i njëjti tregtar me pakicë dhe/ose shumicë;

"Telemetri" do të thotë pajisjet e komunikimit të përdorura për transmetimin e të dhënave të mbledhura nga një instalim matës në një sistem qendror të menaxhimit të të dhënave dhe zakonisht përfshijnë modem, telekom fiks (i cili mund të jetë i dedikuar ose pjesë e një rrjeti PSTN) ose marrës radio (i cili mund ose mund të mos jetë në formën e një rrjeti radiofonik të dedikuar, GSM, GPRS, CDMA, 3G, telefonisë satelitore ose ndonjë rrjeti tjetër të krahasueshëm);

"Testimi i tipit" do të thotë testimi i kryer për të vendosur aftësinë për qëllimin e një lloji të ri të instalimit të matjes;

"Kufiri i pasigurisë" do të thotë diapazoni brenda të cilit do të përsëriten rezultatet e testit kur një test përsëritet.

Interpretimi

Në këtë kod të matjes, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe:

a) titujt dhe shënimet në fund të faqes janë vetëm për lehtësi ose informacion dhe nuk ndikojnë në interpretimin e këtij kodi të matjes ose të ndonjë termi ose kushti të përcaktuar në këtë kod të matjes;

b) fjalët që importojnë njëjësin përfshijnë shumësin dhe anasjelltas;

c) një shprehje që importon një person fizik përfshin çdo kompani, partneritet, besim, ndërmarrje të përbashkët, shoqatë, korporatë ose organ tjetër korporate dhe çdo agjenci qeveritare dhe anasjelltas;

d) një referencë në një klauzolë ose shtojcë është në një klauzolë ose shtojcë të këtij kodi të industrisë;

e) një referencë ndaj çdo statuti përfshin të gjitha statutet që ndryshojnë, konsolidojnë, rizbatojnë, shtrijnë ose zëvendësojnë ato dhe një referencë ndaj një statuti përfshin të gjitha rregulloret, shpalljet, urdhëresat, aktet nënligjore dhe përcaktimet e nxjerra në bazë të këtij statuti;

f) një referencë ndaj një dokumenti ose një dispozite të një dokumenti përfshin një ndryshim ose plotësim, ose zëvendësim ose riparim të atij dokumenti ose asaj dispozite të këtij dokumenti;

g) një referencë për një person përfshin ekzekutuesit, administratorët, pasardhësit, zëvendësuesit e atij personi (duke përfshirë, pa kufizim, personat që marrin me rishtar) dhe caktimet e lejuara;

h) pjesët e tjera të fjalës dhe format gramatikore të një fjale ose fraze të përcaktuar në këtë kod të industrisë kanë një kuptim përkatës;

i) një periudhë kohe:

i. që daton nga një ditë e caktuar ose dita e një veprimi ose ngjarjeje do të llogaritet përjashtuar nga ajo ditë; dhe

ii. e cila fillon në një ditë të caktuar ose ditën e një akti ose ngjarjeje do të llogaritet duke përfshirë atë ditë.

j) një referencë për:

i. koha është një referencë në kohën standarde brenda kuptimit të Aktit të Kursimit të Ditës (*Daylight Sving Act*) 1971 (SA) dhe jo Koha e Verës brenda kuptimit të këtij akti;

ii. një ditë është një referencë për një periudhë që fillon menjëherë pas mesnatës dhe përfundon në mesnatën pasuese; dhe

iii. një muaj është një referencë për një muaj kalendarik.

k) një ngjarje, e cila kërkohet nën çdo term ose kusht të përcaktuar në këtë kod të industrisë për të ndodhur në ose nga një ditë e përcaktuar, e cila nuk është një ditë pune, mund të ndodhë në ose në ditën tjetër të punës.

7. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

7.1 "Kodi i matjes" hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCË 1 – VLERËSIMI, ZËVENDËSIMI DHE PARASHIKIMI – INSTALIMI I MATËSIT ME INTERVAL

1. Kërkesa për të vërtetuar leximet e matësve

Leximet aktuale të matësve do të kërkohen të vërtetohen në përputhje me pikën 4.4.1 (a) të këtij "Kodi të matjes". Rregullat e vlefshmërisë që mund të zbatohen në të dhënat e matësit, nga matësit një instalimi të matjes së intervalit, janë:

a) të dhënat e matësit së konsumit për periudhën e leximit të matësve= shuma e të dhënave të matjes së intervalit për periudhën e leximit të matësit;

b) vlera e akumuluar e leximit e matësit është numerike dhe ≥ 0;

c) vlera e akumuluar e leximit e matësit është ≥vlera e mëparshme e lexuar e matësit të grumbulluar;

d) vlera e akumuluar e leximit të matësit kalon provën e lartë/e ulët;

e) data/koha e leximit të matësit> data/koha e leximit të matësit të mëparshëm;

f) vlera maksimale (për të siguruar që nuk krijohen kulme);

g) kontrollet e pavlefshme;

h) kapacitetin e thirrjes dhe kontrollin e pikës dhjetore; dhe

i) të dhënat e matësit janë në përputhje me llojin e saktë të matësve për atë pikë të dorëzimit.

2. Kërkesa për të prodhuar të dhëna matëse të zëvendësuara

Në përputhje me pikën 4.4.1 (b) të këtij kodi të industrisë, të dhënat e matësit për një instalim të matjes së intervalit do të kërkohet të zëvendësohen kur:

a) leximi aktual i matësit dështon në testet e vërtetimit;

b) ka një dështim të instalimit të matësit; ose

c) një inspektim ose testim në instalimin e matësit përcakton se ekziston një gabim i matjes.

3. Kërkesa për të prodhuar të dhëna të parashikuara të matjes

Në përputhje me klauzolën 4.5 të këtij kodi të industrisë, të dhënat e matësit për një instalim të matjes së intervalit do të kërkohet të vlerësohen kur të dhënat e matësit nuk mund të merren në afatin e kërkuar për zgjidhjen e tregut.

4. Detyrimet e transmetuesit ose shpërndarësit

a) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë llojet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 ose 8 teknika, në përputhje me klauzolën 5 të këtij programi 1, kur kërkohet që të dhënat e matësit të zëvendësohen;

b) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë teknikat e llojeve 1, 2, ose 3, në përputhje me pikën 5 të këtij programi 1, kur kërkohet të vlerësohen të dhënat e matësit;

c) transmetuesi ose shpërndarësi mund të përdorë tipin 2, përveç kur leximi i parë aktual i matësit nuk është ndërmarrë;

d) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë tipin 3, përveç kur:

i. leximi i parë aktual i matësit nuk është ndërmarrë; ose

ii. frekuenca e planifikuar e leximit të matësit është më pak e shpeshtë sesa ajo mujore dhe të dhënat nga periudha e njëjtë, ose e ngjashme, e leximit të matësit në vitin paraprak janë në dispozicion;

e) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë llojet 4, 5, 6 dhe 7 në rrethanat e përshkruara në pikat 5.4, 5.5, 5.6 dhe 5.7 të këtij programi 1, përkatësisht;

f) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë tipin 7 përpara se të ndërmerret leximi i parë aktual i matësit;

g) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë tipin 8 kur ka një gabim në presionin e matësit dhe/ose temperaturën e gazit;

h) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të njoftojë tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë kur përdoren të dhëna matëse të zëvendësuara ose të vlerësuara;

i) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që për të gjitha llojet, përveç tipit 5, të dhënat e matësit, të zëvendësuara ose të vlerësuara, të bazohen në një lexim aktual të matësit, dhe të mos bazohet në të dhëna matëse që janë vlerësuar ose zëvendësuar më parë.

5. Tipat e zëvendësimit dhe parashikimit

Teknikat për zëvendësimin dhe parashikimin e të dhënave të matjes për instalimet e matjes së intervalit janë parashikuar në këtë klauzole.

5.1 Tipi 1

Kur ka një instalim tjetër të matjes së intervalit në të njëjtën pikë matjeje për të njëjtën periudhë të të dhënave intervale me atë që zëvendësohet, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të zëvendësojë ose vlerësojë të dhënat e matësit duke përdorur të dhëna matëse nga ai instalim i matjes së intervalit.

5.2 Tipi 2

Transmetuesi ose shpërndarësi mund të zëvendësojë ose të vlerësojë të dhënat e matësit duke përdorur të dhënat nga "Dita e Ekuivalentit më të Afërt" ose "Ashtu si Dita" nga e njëjta periudhë e leximit të matësit në vitin e kaluar. "Dita e Ekuivalentit më të Afërt" ose "Ashtu si Dita" përcaktohet nga tabela më poshtë.

Dita	**"*Nearest Equivalent Day*" or "*Like Day*" (*in order of availability*)**
E hënë E martë E mërkurë E enjte E premte E shtunë E diel	E hënë ♦♦ E hënë♦ E mërkurë ♦♦ E martë ♦ E mërkurë ♦ E mërkurë ♦♦ E martë ♦♦ E enjte ♦♦ E mërkurë ♦ E enjte ♦ E martë♦ E enjte ♦♦ E mërkurë ♦♦ E martë ♦♦E enjte ♦ E mërkurë ♦ E martë ♦E martë ♦♦ E premte ♦ E shtunë ♦♦ E shtunë ♦ E diel ♦♦ E diel ♦
Zëvendësimi ose vlerësimet për 'Ashtu si Dita' të jenë të detajuara më sipër, përveç nëse: ● Asnjë lexim nuk është i disponueshëm në ditën e parë të listuar, atëherë do të përdoret dita tjetër e preferuar e listuar. ? Dita ishte një festë publike, me atë rast do të përdoret e diela më e fundit. ? Dita nuk ishte një festë zyrtare dhe 'Si Dita' është një festë zyrtare, në këtë rast '*Si Day*" që do të përdoret duhet të jetë dita më e fundit që nuk është festë zyrtare, e Shtunë ose e Diel. ♦♦ Ndodh në të njëjtën javë me ditën në vitin e kaluar. ♦ Ndodh në javën paraardhëse në atë në të cilën dita e zëvendësimit ndodh në vitin e kaluar.	

5.3 Tipi 3

OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të zëvendësojë ose vlerësojë të dhënat e matësit duke përdorur të dhënat nga "Dita më e Afërt Ekuivalente" ose "Si Dita" nga leximet e mëparshme të matësve. "Dita e Ekuivalentit më të Afërt" ose "Si Dita" përcaktohet nga tabela më poshtë.

Day	**"*Nearest Equivalent Day*" or "*Like Day*" (*in order of availability*)**
E Hënë E Martë E Mërkurë E enjte E Premte E Shtunë E Diel	E Hënë ♦♦ E Mërkurë ♦♦ E Enjte♦ E Mërkurë ♦♦ E Martë ♦E Enjte ♦♦ E Martë ♦♦♦ E Enjte ♦♦ E Mërkurë ♦ E Martë ♦ E Mërkurë ♦♦ E Martë ♦♦ E Premte ♦♦ E Shtunë ♦♦ E Diel ♦♦

Zëvendësimet ose vlerësimet për '*Like Day*' të jenë si më sipër të detajuara, përveç nëse: ● Asnjë lexim nuk është i disponueshëm në ditën e parë të listuar, atëherë do të përdoret dita tjetër e preferuar e listuar. ● Dita ishte një festë publike, në rastin kur do të përdoret e diela më e fundit. ● Dita nuk ishte një festë publike, por dita e preferuar është një festë zyrtare, në rastin e '*Like Day*' që do të përdoret duhet të jetë dita e preferuar më e fundit që nuk është festë zyrtare. ♦♦Ndodh në javën që paraprin atë në të cilën ndodh dita e vlerësimit. ♦ Ndodh në të njëjtën javë si dita e vlerësimit.

5.4 Tipi 4

Të dhënat e matësit të zëvendësuar, të përdorura më parë, mund të ndryshohen para leximit aktual të matësit, ku tregtari ka rënë dakord, në bazë të informacionit specifik të faqes ose të klientit, që të dhënat origjinale të matjes, të zëvendësuara, janë në gabim dhe kërkohet një korrigjim.

5.5 Tipi 5

Të dhënat e matësit, të zëvendësuara, mund të krijohen duke përdorur ndërlidhjen e thjeshtë lineare kur tregtari me pakicë ka rënë dakord.

5.6 Tipi 6

a) tregtari me pakicë dhe/ose shumicë mund të pranojë të përdorë një metodë tjetër të zëvendësimit (e cila mund të jetë një modifikim i një lloji ekzistues) kur asnjë nga llojet ekzistuese nuk është i zbatueshëm;

b) specifikat e këtij lloji mund të përfshijnë një metodë të zbatuar globalisht ose një metodë specifike sipas vendndodhjes.

5.7 Tipi7

Para leximit të parë aktual të matësit, të dhënat e matësit mund të zëvendësohen duke përdorur një metodë të rënë dakord midis tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë dhe OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar.

5.8 Tipi 8

Kur gabimi i matjes ka lindur nga gabimet në temperaturën e gazit dhe/ose presionin e gazit, të dhënat e matësit mund të zëvendësohen duke përdorur leximin e matësit dhe vlerësimet për temperaturën e gazit dhe/ose presionin e matësit.

SHTOJCË 2 – VLERËSIMI, ZËVENDËSIMI DHE PARASHIKIMI – INSTALIMI I MATËSIT BAZIK

1. Kriteret për të vlerësuar leximet e matësve

Lexime aktuale të matësve do të kërkohet të vlerësohet në përputhje me klauzolën 4.4.2 (a) të këtij kodi të industrisë. Rregullat e vlefshmërisë që mund të zbatohen në të dhënat e matësit nga matësi i një instalimi bazë të matjes janë:

a) vlera e leximit të matësit është numerike dhe ≥ 0;

b) vlera e leximit të matësit është ≥ vlera e leximit të matësit të mëparshëm;

c) vlera e leximit të matësit kalon testin e lartë/e ulët;

d) data e leximit të matësit > data e leximit të matësit të mëparshëm;

e) kontrollet e pavlefshme;

f) kontrolli i kapacitetit të thirrjes dhe pikës dhjetore; dhe

g) të dhënat e matësit janë në përputhje me llojin e saktë të matësit për atë pikë transmetuesi dhe/ose shpërndarjeje.

2. Kriteret për të prodhuar të dhëna matëse të zëvendësueshme

Në përputhje me pikën 4.4.2 (b) të këtij kodi të matjes, të dhënat e matësit për një instalim bazë të matjes do të kërkohet të zëvendësohen kur:

a) leximi aktual i matjes dështon në testet e vlerësimit;

b) ka një dështim të instalimit të matjes;

c) një inspektim ose provë në instalimin e matjes përcakton se ekziston një gabim i matjes; ose

d) një lexim i vlerësuar lejohet sipas Transfertës së Energjisë së Klientit dhe Kodit të Miratimit dhe kërkohet të transferojë një klient te një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë i ri.

3. Kriteret për të prodhuar të dhëna të vlerësuara të matjes

Në përputhje me klauzolën 4.5 të këtij kodi të matjes, të dhënat e matësit për një instalim bazë të matjes do të kërkohet të vlerësohen aty ku të dhënat e matësit nuk mund të merren në afatin e kërkuar për zgjidhjen e tregut.

4. Detyrimet e shpërndarësit

a) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdori tipat 1, 2, 3, 4, 5 ose 6, teknikat në përputhje me pikën 5 të këtij programi 2, kur kërkohet që të dhënat e matësit të zëvendësohen;

b) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdori tipat 1, 2 ose 3, teknikat në përputhje me pikën 5 të këtij programi 2, kur kërkohet që të dhënat e matësit të vlerësohen;

c) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdori tipin 6 kur ka një gabim në presionin e matësit dhe/ose temperaturën e gazit;

d) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të njoftojë tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë kur përdoren të dhënat e matjes të zëvendësuara ose të vlerësuara:

i. transmetuesi dhe/ose shpërndarësi duhet të sigurojë që për të gjitha tipat, të dhënat e matësit të zëvendësuara ose të vlerësuara bazohen në një lexim aktual të matësit dhe nuk bazohet në të dhëna matëse që janë zëvendësuar ose vlerësuar më parë.

5. Tipat e zëvendësimit dhe të vlerësimit

Teknikat për zëvendësimin dhe vlerësimin e të dhënave të matjes për instalimet bazike të matjes janë parashikuar në këtë klauzolë.

5.1 Tipi 1

Zëvendësimi ose vlerësimi = Konsumi mesatar ditor nga periudha e leximit të matësit të vitit të kaluar, e njëjtë, ose të ngjashëm

* Numri i ditëve të kërkuara për t'u zëvendësuar ose vlerësuar.

5.2 Tipi 2

Zëvendësimi ose vlerësimi = Konsumi mesatar ditor nga periudha e leximit të matësit paraardhës

* Numri i ditëve të kërkuara për t'u zëvendësuar ose vlerësuar.

Shënim: Kur frekuenca e leximit të matësit të planifikuar është më pak e shpeshtë se mujore, tipi 2 duhet të përdoret vetëm kur konsumi nga periudha e leximit të matësit të njëjtë, ose të ngjashëm, i vitit të kaluar nuk është i disponueshëm.

5.3 Tipi 3

Zëvendësimi ose vlerësimi = Konsumi mesatar ditor për të njëjtën klasë konsumatori me të njëjtin lloj përdorimi

* Numri i ditëve të kërkuara për t'u zëvendësuar ose vlerësuar

Shënim: Tipi 3 do të përdoret vetëm kur konsumi nga periudha e leximit të njëjtë, ose të ngjashëm, i vitit të kaluar dhe konsumi nga periudha e leximit të matësit nga periudha e leximit të matësit të mëparshëm nuk janë të disponueshme.

5.4 Tipi 4

a) Tregtari me pakicë dhe/ose shumicë dhe OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të bien dakord të përdorin një metodë tjetër të zëvendësimit (e cila mund të jetë një modifikim i një tipi ekzistues) ku asnjë nga tipat ekzistues nuk është i zbatueshëm.

c) Specifikat e këtij tipi mund të përfshijnë një metodë të zbatuar globalisht ose një metodë specifike në varësi të vendndodhjes.

5.5 Tipi 5

Të dhënat e matësit, të zëvendësuara, të përdorura më parë, mund të ndryshohen, para leximit të matësit aktual, kur tregtari me pakicë dhe/ose shumicë dhe OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar kanë rënë dakord, në bazë të informacionit specifik për vendin ose klientin, se të dhënat origjinale të matjes së zëvendësuar janë në gabim dhe kërkohet një korrigjim.

5.6 Tipi 6

Kur gabimi i matjes ka lindur nga gabimet e bëra në matjen e temperaturës së gazit dhe/ose presionit të matësit, të dhënat e matësit mund të zëvendësohen duke përdorur leximin e matësit dhe vlerësimet për temperaturën e gazit dhe/ose presionin e matësit.